

LIGJ
Nr.10 274, datë 6.5.2010

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES USHTARAKE TË GRANTIT NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË
SË REPUBLIKËS SË TURQISË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ushtarake e grantit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6568, datë 18.5.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**MARRËVESHJA USHTARAKE
E GRANTIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË TURQISË**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Turqisë (referuar pas kësaj si “Pala” ose “Palët”);

Duke marrë parasysh “Marrëveshjen mbi bashkëpunimin në fushat e trajnimit ushtarak, teknikës dhe shkencës”, datë 29 korrik 1992 dhe “Marrëveshjen e bashkëpunimit dhe trajnimit ushtarak” të datës 19 nëntor 1992;

Në kuadër të fushës së veprimit të marrëdhënieve të tyre të gjata miqësore, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ushtarak dhe kontributit të tyre për ristrukturimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,
kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Qëllimi

Qeveria e Republikës së Turqisë do t’i japë një grant prej 787 500 (shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lira turke ekuivalente në dollarë amerikanë, Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Granti do të jetë i disponueshëm nga viti 2009.

Neni 2
Fusha e veprimit

Si pjesë e kësaj Marrëveshjeje, granti prej 727 500 (shtatëqind e njëzet e shtatë mijë e pesëqind) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë do të sigurohet në materiale dhe shërbime, 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lira turke ekuivalente në dollarë amerikanë do të sigurohen në para, në përputhje me legjislacionin përkatës të Qeverisë së Republikës së Turqisë.

Neni 3
Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

Kjo Marrëveshje do të zbatohet nga Shtabi i Përgjithshëm Turk në emër të Qeverisë së Republikës së Turqisë dhe nga Ministria e Mbrojtjes në emër të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pikat e kontaktit për këtë Marrëveshje janë zyra e atasheut ushtarak shqiptar në Ankara, Turqi dhe zyra e atasheut ushtarak turk në Tiranë, Shqipëri.

Neni 4
Parimet e zbatimit

787 500 (shtatëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lira turke, ekuivalente në dollarë amerikanë, do të realizohen në përputhje me asistencën financiare dhe protokollet zbatuese logjistike që do të nënshkruhen veçmas ndërmjet zyrtarëve të të dyja palëve të referuara në këtë Marrëveshje.

Neni 5
E drejta e përdorimit të materialeve dhe shërbimeve

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë bie dakord të mos ia transferojë titujt ose të drejtën e përdorimit të materialeve dhe shërbimeve një vendi tjetër ose pale të tretë, pa pëlqimin paraprak të Republikës së Turqisë.

Neni 6
Çështje të tjera

Dispozitat e marrëveshjeve të referuara në paragrafin hyrës do të mbizotërojnë për çështje që ndodh të hasen gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, si dhe për çështje që nuk rregullohen brenda kësaj Marrëveshjeje. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të kufizojnë asnjë të drejtë të parashikuar në Marrëveshje të tjera të lidhura midis palëve.

Neni 7
Hyrja në fuqi, përfundimi, teksti dhe nënshkrimi

Marrëveshja do të hyjë në fuqi datën kur çdo palë do të marrë njoftimin e fundit me shkrim përmes kanaleve diplomatike për përfundimin e të gjitha procedurave ligjore të kërkuara për hyrjen në fuqi të saj.

Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi derisa të gjitha materialet dhe shërbimet, siç përcaktohet në protokollet zbatuese t'i dorëzohen Ministrisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë.

Kjo Marrëveshje është përgatitur në dy kopje origjinale, secila në gjuhën shqipe, turke

dhe angleze, të gjitha tekstet janë të barasvlershme. Në rast mospërputhjeje, lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, versioni anglisht i Marrëveshjes do të mbizotërojë.

Çdo mosmarrëveshje që lind gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet me diskutime dhe bisedime dypalëshe.

Kjo Marrëveshje është nënshkruar më 3.12.2009, në Ankara, Turqi.

Në emër të Këshillit Të Ministrave të
Republikës së Shqipërisë
Emri: Altin Kodra
Detyra: Ambasadori i Republikës së Shqipërisë

Në emër të Qeverisë të Republikës së Turqisë
Emri: Alpaslan Erdogan
Detyra: Gjeneral Major
Drejtori i Menaxhimit të Resurseve dhe
Zhvillimit të Forcave të Armatosura në Shtabin
e Përgjithshëm të Ushtrisë Turke